



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 188/3 Prot

Tiranë, më 08. 4 .2016

VENDIM

Nr. 09 ,datë 08. 4 .2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit, klinika "*KAJO*", me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik, NIPT:L21530002M,,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr.30, datë 22.02.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 25.02.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procedurën e hetimit administrativ, pranë kontrolluesit klinika "*KAJO*" sh.p.k., me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit "*KAJO*" sh.p.k, i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi grupi i inspektimit ka konstatuar:

1. Kontrolluesi, nuk ka parashikuar në kontratën me punëmarrësit, Deklaratën e Konfidencialitetit, konform standartit të përcaktuar në Vendimin Nr.6, datë 05.08.2013, i Komisionerit. Rubrika "*Konfidencialiteti i informacionit*" pjesë e kontratës midis punëmarrësit dhe punëdhënësit, shprehet në parim, dhe nuk ka sens apo saktësisht të shprehet, për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale të pacientëve.
2. Kontrolluesi, në rregulloren e klinikës "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", në lidhje me përkufizimin "*Përpunues*", ka trajtuar si përpunues strukturat e kontrolluesit, kur në kuptim të ligjit, janë palët e treta.

3. Në asnjë moment, nuk është përmendur përkufizimi mbi mekanizmin e "Pëlqimit", si një nga mekanizmat realë i cili sanksionon të drejtën që subjekti i të dhënave ka mbi të dhënat e tij.

Për shkeljet e konstatuara në vend, është mbajtur procesverbali i konstatimit, i cili u firmos nga kontrolluesi, i cili u shpreh:

"Nuk jam dakort me pikën I, sepse mendoj që kërkesat janë shprehur në kontratat aktuale. Gjithsesi jam i gatshëm të shtoj informacionin".

Në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, për respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në datë 05.04.2016 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit, i cili kishte rikuperuar të gjitha shkeljet e konstatuara në lidhje me gjetjet e grupit të inspektimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Rezulton se, kontrolluesi pavarësisht se i ka ezauruar konstatimet e grupit të kontrollit, në kushtet e gjetura gjatë hetimit administrativ, mbetet në shkelje të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Kontrolluesi ka patur gjithë mundësinë për t'u njohur me ligjin dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, dhe aktet e tjera nënligjore.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ në kuptim të nenit 39, paragrafi 1 gërma "a" të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

a) *"kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me Kreun II "Përpunimi i të dhënave personale, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;"*.

Kontrolluesi, klinika "KAJO" sh.p.k., në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën I të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se kontrolluesi ka qënë në bashkëpunues me grupin e inspektimit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, por shkeljet e konstatuara edhe pse të rikuperuara prej tij, ato lidhen me sigurinë e të dhënave personale dhe parimet bazë të mbrojtjes së të dhënave personale.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 7, 30, 31, 39/1, shkronja "a", 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit, klinika "KAJO" sh.p.k., me gjobë, në vlerën **20 000 (njëzetëmijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në Kreun II, referuar neneve 6 dhe 7 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

2. Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot në, 08.4 .2016

